

RAPORT NGA KAMPI VERORË PËR FËMIJË "ULQIN 2005" 24 GUSHT – 5 SHTATOR

Organizuar dhe implementuar nga HANDIKOS –si
Mbeshtetur nga ONLUS R. BAZZONI

STAFI PËRGJEGJËS:

1. BRILANTA BALLATA
Përgjegjëse e kampit
2. GJEMILE SAHITI
Ndhmës përgjegjëse
3. LULJETA MUSOLLI
Trajnerë për aktivitete
psiko-motorike
4. HATIGJE SALIHU
Trajnerë e rehabilitimit primar
fizikal



PJESMARRËSIT: 23 Fëmijë, 10 Qendra të Rehabilitimit nga 2 fëmijë ,një nga Deqani, Malisheva dhe Suhareka.

GJINIA: 14 djem 9 vajza .Përcjellës kanë qenë 20 nëna,2 motra dhe 1 gjyshe.
Prej 23 fëmijëve 8 kanë qenë me dg. PARALYSIS CEREBRALIS, 6 HEMIPARESIS, 6 SY.
DAWN, 1 PARESA PLEXUS BRACHIALIS, 1 POLIO,DHE 1 R.P.M. Prej tyre 5 fëmi kanë
qenë të operuar.

VENDI: Në Hotel FLORIDA Ulqin ne plazhin e vogël.

TRANSPORTI: Një autobus nga kompania turistike "Shpejtimi" ,

UDHËTIMI (nisja –mbërritja) : Udhëtimi ishte dy ditë. Nisja nga Prishtina 24.08.05 ora
21:00 dhe arritja 25.08.05 ora 7:00, si dhe kthimi në Kosovë me 4.09.05 ora 2:00 dhe arritja me
5.09.05 ora 6:30.

Gjate kthimit ne Kosove kemi pasur një problem me një nënë nga Prizereni ku është sëmurë
dhe i është nevojitur ndihma mjekësore, deri në kufirin e Kosovës ka udhëtuar me autobus
pastaj me kombin e qendrës së Handikosit te Prizerenit deri ne Prizeren.

AKTIVITETET GJATË KAMPIT: Plani dhe orari është përpiluar nga 4 punëtorët më parë, në çdo dhomë është vendosur në dyer dhe prezantuar nënave. Është bërë marrëveshja me pronarin e Hotelit për mëngjes në ora 8.00 Dreka 13.00 Darka 19.15 .

HAPJA CEREMONIALE / Mirëseardhja: Hapja dhe mirëseardhja u bë pas darkës në ditën e parë, më 25.08 nga përgjegjësja e kampit dhe gjithashtu u bë prezantimi i personelit, detyrat e tyre si dhe prezantimi i planit dhe orarit. Këtë mbrëmje secilit fëmijë, nga personeli përgjegjës ju shpërndanë dhuratat, maica si dhe i argëtuan me një lojë. Në dhuratat kishte nga 1 libër për ngjyrosje, ngjyra, vetura për djemtë kurse për vajzat nga një kukull, një lapsë, nga një prerse, nga një çokollatë si dhe maicat me logon HANDIKOS ,R BAZZONI, Ulqini 2005 dhe për ndryshim nga vitet e kauara, këtë vit për nder dhe kontributit të çmuar të Julia Pallao në përkrahjen fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara dhe HandiKOS`it, në maica vendosem edhe emrin e Dr. JULIA .PALAO,



AKTIVITETET E FIZIOS DHE PSIKOS: Në ditën e dytë, fëmijët i ndamë në dy grupe A fizio –terapi me 12 fëmijë dhe grupi B psiko-sociale me 11 fëmijë dhe këto dy aktivitete janë ndërruar çdo ditë. (një ditë psiko një ditë fizio).

AKTIVITETET E FIZIOS: është punuar me mobilizim pasiv ,autonomia personale, janë dhënë këshilla për konsultim me doktor për të parë mundësin e operimeve të tetivave, janë dhënë këshilla për karrige speciale dhe u janë edhe këshilla të tjera me qëllim të përmasimit të gjendjes së fëmijëve.

AKTIVITETET E PSIKOS: gjatë këtij kampi është punuar punë didaktike (përdorim i lapsit, ngjyrosje, puna me gërshtë) dhe në fund është bërë edhe përgatitja e ekspozitës së punimeve nga vetë fëmijët.

TAKIMET ME NËNAT: Gjatë qëndrimit në kamp kemi mbajtur 5 dite takime me nënat. Këto takime kanë qenë të ndara sipas aftësive të kufizuara (diagnozave) të fëmijëve, me: Paralysis Cerebralis, Hemiparesis, Polio, RPM, PPB, Sy Dawn si dhe në takimin e fundit kemi pasur diskutime të lira me të gjitha nënat. Arsyeja e takimeve ishte që nënave t`u ofrohen sa më shumë njohuri rreth paaftësive të fëmijëve të tyre, aftësive të fëmijëve, pavarësimit sa më të madh të fëmijëve por edhe puna që vetë nënat mund të bëjnë në përmasimin e gjendjes së fëmijëve në shtëpi.



Në këto takime gjithashtu u diskutuan edhe broshurat që janë publikuar më herët nga HandiKOS`i, dhe u janë informata të shumta rreth HandiKOS`it e po ashtu edhe për mbështesin financiar të kampeve Onlus R. Bazzoni.

AKTIVITETE REKREATIVE (në plazh): është organizuar çdo ditë, prej orës 10 .00 deri në ora 12.45. Si aktivitete kanë qenë, noti dhe punime të ndryshme me rërë. Personeli përgjegjës nga HandiKOS`i, së bashku me nënat janë përkujdesur për fëmijë si dhe kanë këshilluar ata që të hyjnë në ujë meqenëse në fillim të gjithë fëmijët kishin frikë nga uji por edhe nga vetë ambienti. Pas disa ditëve, të gjithë fëmijët hynin në ujë dhe kënaqeshin duke lozur ku disa prej tyre as nuk donin të dilnin nga uji sepse iu kishte pëlqye shume.

Po ashtu çdo ditë pas drekës është organizuar dalja në plazh dhe janë organizuar aktivitete (lojëra) të ndryshme me fëmijë, parashuta, litarë, thasët e rërës, me rrathë etj. Fëmijët argëtoheshin shumë dhe ishin shumë aktiv, gjithashtu edhe nënat kënaqeshin duke i shikuar fëmijët e tyre.



LUNA PARK : Në ditën e katërt, pas darkës fëmijët janë dërguar në Luna park ku janë argëtuar shumë, ky ishte një aktivitet i ri për fëmijët meqenëse nuk kishin pasur kurrë deri më tani rast të përjetojnë Luna parkun.

Përgjegjësi i Luna Parkut, shprehu dëshirë që fëmijëve tu dhurojë nga një dhuratë si dhe nga një gjiro gratis për të gjithë fëmijët.

UDHTIMI ME ANIJE: Në ditën e nëntë, pas mëngjesit kemi udhëtuar me anije në plazh të madhe, vizitë dy grupeve të rriturve. Fëmijët dhe nënat ishin shumë të kënaqura (Kishte fëmijë dhe nëna që hera e pare udhëtonin me anije). Në plazhin e madh u takuam me dy grupet e të rriturve (personat me lëndime të palcës kurrizore si dhe grupin me aftësi të kufizuar të ndryshme) ku kemi mbajtur disa lojëra argëtuese për fëmijë



AKTIVITET E MBRËMJES: Në ditën e tretë në mbrëmje, me fëmijët kemi organizuar: recitime të vjershave, këndimin, vallëzimin dhe në fund një **maskemball** me maska të ndryshme. Fëmijët ishin shumë aktiv dhe atraktiv, sidomos në vallëzim dhe maskat që kishin përgatitur me nënat e tyre. Gjithashtu një ditë më vonë në mbrëmje edhe vetë nënat organizuan një show/shfaqje, humor dhe argëtim.



Në ditën e shtatë, është mbajtur kuizi i cili kryesisht ka pasur të bëjë me HandiKOS`in, aktivitet si dhe historikun e përkrahjes nga Onlus R. Bazzoni. Ky kuiz u mbajt me nënat e fëmijëve ku ishin prezentë edhe të gjithë fëmijët, pyetjet i bënte menaxheri i programit i programit Afrim Maliqi, dhe për çdo përgjigje të saktë nënave u jepnim dhurata (fotografi nga kampi – Ulqini 2005)

MBRËMJA E FUNDIT (PARTY) - sikurse edhe viteve të mëhershme natën e fundit kemi organizuar një aheng (party) me qëllim të argëtimit për të gjithë pjesëmarrësit. Në këtë natë janë ekspozuar edhe punimet e fëmijëve që kishin punuar gjatë qëndrimit në kamp.

VLERËSIMI NGA NËNAT: Në ditën a parafundit të kampit, nënave iu janë shpërndarë fletë –vlerësimet me shkrim, rreth përshtypjeve të tyre gjatë qëndrimit në kampin 10 ditor Ulqini 2005.

Të gjitha nënat ishin shumë qenë shumë të kënaqura e sidomos ndryshimet pozitive që kishin vërejtur të fëmijët e tyre. Po i përmendim vetëm disa prej tyre:

"(fëmijët nuk frikohen më nga uji, janë shumë më të shoqëruar se sa më parë, kanë filluar të ushqehen vetë, të vishen dhe zhvishen vetë, një fëmijë deri më tani nuk kishte recituar kurse tani po, fëmija im tani tregon për nevoja e tij fiziologjike, fëmijët të cilët janë operuar me referencat e Dr. Julia Pallao u ka ndihmuar shumë)"

Falënderime të shumta kishte për Dr. Julia Pallao e cila me punën e palodhshme gjatë këtyre viteve u kishte ndihmuar shumë nënave dhe fëmijëve e sidomos falënderim i posaçëm ishte për mbështetësin e kampit Onlus R. Bazzoni. Për këtë fëmijët shkruan edhe fjalë falënderuese si dhe një vjershë:

*" Përshëndetje nga Kosova mirë se të gjen
kjo letër e jona. Të gjithë fëmijët që nuk
flasin e nuk ecin ty të përshëndesin, Të
urojnë kudo që të jesh gëzim, shëndet,
lumturi në jetë. Ardhja e juaj na nderon
këta fëmijë na i gëzon"*
Të fala të përzemërta,
Zoti ju bekoftë

PENGESAT EVENTUALE:

Gjatë qëndrimit në kamp nuk kemi pasur pengesa në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara, përveç dy fëmijëve të cilët njëri për shkaqe shëndetësore kurse tjetri për arsye familjare (rast vdekjeje në familje), janë kthyer një ditë para përfundimit të kampit.

KUJDESI MJEKËSOR – meqenëse këtë vit me ne nuk ishte Dr. Julia, gjithë kujdesin mjekësor për fëmijë e ka ofruar motra mjekësore nga grupi i të rriturve me lëndime të palcës kurrizore Kimete Shabani. Me gjithë mundësit dhe përkushtimin e saj vlerësojmë se në organizmin e kampeve tjera për vitet e ardhshme është e nevojshme të kemi një doktor.

PËRKRAHJA GJATË QËNDRIMIT NË KAMP, NGA TË TJERËT PËR:

- Përgjegjësia e plazhit dhe çadrave i cili na mundësoi një pjesë të hapësirës në plazh.
 - Pronarin e Hotelit për mirësjelljen e tij dhe ofrimin e shume shërbime tjera të cilat nuk ishin me marrëveshje.
 - Njerëzit e tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndihmuan dhe përkrahën fëmijët: (banane për fëmijë 20kg, nga mini-marketi afër Hotelit, krofneve ku për çdo ditë ka jap nga 50 copa për fëmijët dhe nënat, kafe për nënat dhe qaj për fëmijët nga një person tjetër. Një person nga Mitrovica ju ka dhuruar fëmijëve nga një dhuratë me lodra të ndryshme, pronarin e Luna Parkut ku ju dha dhurata për të gjithë fëmijët si dhe gjiro në Luna park, pronarin e anijes i cili na mundësoi vetëm pagesën për shpenzime të karburantit.
- Falënderim për njerëzit në plazh të cilët na kanë ndihmuar shumë në bartjen e fëmijëve,
Falënderim për gjithë personelin e Hotelit për angazhimin, kujdesin ndaj fëmijëve dhe nënave.
- Falënderim i madh, i takon teknikes mjekësore Kimete Shabani si dhe Bedrie Beqiri e cila ka qenë në cilësinë e vullnetares për kujdesin mjekësor gjatë gjithë qëndrimit në kamp.

Përgjegjësja e kampit
Brilanta Ballata